



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë më _____.2024

VENDIM
Nr. 715, datë 06.12.2023

PËR
KUALIFIKIMIN DHE LEJIMIN PËR TË MARRË PJESË NË PROVIMIN E
VLERËSIMIT PROFESIONAL TË KANCELARES NË DETYRË, ZNJ. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 06.12.2023, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe relacionin “*Mbi gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të pozicionit, pasurisë dhe figurës, të kancelares në detyrë znj. {...}*”, përgatitur nga relatorja e procedurës së verifikimit znj. Fatmira Luli, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për kualifikimin dhe lejimin e saj për të marrë pjesë në provimin e vlerësimit profesional të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës;

VËREN:

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Znj. {...} ka qenë kancelare në detyrë pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës. Me Vendimin nr. 496, datë 21.10.2020, bazuar në nenet 53, 55, 56 dhe 83, të ligjit nr.98/2016, “*Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*”, si dhe në Vendimin nr. 424, datë 12.10.2020, “*Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor*” (më poshtë referuar si Vendimi 424/2020), Këshilli i Lartë Gjyqësor ka filluar procedurën e verifikimit për plotësimin e kushteve dhe kritereve ligjore të pozicionit, verifikimin e pasurisë dhe figurës, për kancelarët në detyrë, duke caktuar relatorin për çdo kandidat, ku në bazë të shortit, për kancelaren në detyrë, znj. {...}, si relator u caktua anëtari i Këshillit z. Medi Bici.
2. Në datën 26.10.2020, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu XI, të Vendimit 424/2020, znj.Hysi, në rrugë elektronike, u njoftua:

- për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të pozicionit, të pasurisë dhe figurës për kancelarët në detyrë;
- për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi;
- për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

Kancelarja në detyrë, znj. {...}, u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën elektronike dhe të kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj saj, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

3. Brenda afatit treditor, znj. {...} depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën elektronike dhe të kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj saj. Nga ana tjetër, brenda këtij afati, kancelarja në detyrë nuk parashtrroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

4. Në datën 02.11.2020, bazuar në pikën 11, Seksioni B, Kreu IV, të Vendimit 424/2020, znj.Hysi, në rrugë elektronike, iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 15, Seksioni C.1, Kreu IV, të Vendimit 424/2020) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej saj në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve formale të pranimit në shërbimin civil gjyqësor, si dhe të pasurisë dhe figurës.

5. Në datë 05.11.2020, u njoftua Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI), për listën e kancelarëve në detyrë në proces verifikimi, për të cilët do të kryhet verifikimi pasurisë¹.

6. Brenda afatit treditor, kancelarja në detyrë depozitoi, në zyrën përkatëse të Këshillit, formularët dhe autorizimet përkatëse, ndërsa në datë 13.11.2020, ajo rezultoi se ka dorëzuar rregullisht edhe formularin “Deklaratë e pasurisë dhe interesave private të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë” pranë ILDKPKI-së.

7. Gjatë procedurës së verifikimit, nga data 30.10.2020, bazuar në pikën 15, Seksioni C, Kreu VI, të Vendimit 424/2020 dhe në pikën 2, të nenit 83, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kancelarët në detyrë, ndër ta edhe për znj.Hysi.

8. Institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës si dhe institucionet e tjera të cilat administrojnë informacionin e nevojshëm në kuadër të verifikimit të kushteve dhe kritereve

¹ Shih shkresën nr. 5678 prot, datë 05.11.2020, drejtuar Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

ligjore të pozicionit, kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

9. Me vendimin nr. 8, datë 17.01.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “*Për caktimin e relatorit në procedurat e verifikimit të kancelarëve në detyrë në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe të posaçëm, të papërfundura për shkak të mbarimit të mandatit të anëtarit të këshillit të lartë gjyqësor z. Medi Bici*”, në bazë të shortit, për kancelaren në detyrë, znj. {...}, si relatore u caktua znj. Fatmira Luli.

10. Në datën 18.01.2022, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu XI, të Vendimit 424/2020, znj. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua:

- për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi;
- për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

11. Brenda afatit treditör, znj. {...} nuk parashtroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e ri të caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT

A. Për kushtet/kriteret e përgjithshme ligjore të pozicionit, sipas nenit 55, pika 1, të ligjit nr.98/2016

12. Për kancelaren në detyrë znj. {...}, u verifikuan kriteret e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil gjyqësor, përcaktuar në nenin 55, pika 1, të ligjit nr. 98/2016, kushte të cilat përcaktohen si kriteret e përgjithshme të pranimit në shërbimin civil edhe në nenin 21, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si më poshtë:

a) *Të jetë shtetas shqiptar* – Për këtë kriter, në dokumentin “Kartë Identiteti”, lëshuar nga Ministria e Brendshme, pasqyrohet edhe përbërësi i gjendjes civile “shtetësia”, që në këtë rast pasqyrohet “shqiptare”. Nuk rezulton ndonjë e dhënë për lënien ose heqjen e shtetësisë shqiptare për subjektin pas këtij momenti;

b) *Të ketë zotësi të plotë për të vepruar* – Për këtë kriter, nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen apo kufizimin e saj me vendim gjyqësor të formës së prerë;

c) *Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur* – Zotërimi i gjuhës shqipe të folur dhe të shkruar prezumohet për çdo shtetas shqiptar që ka përfunduar arsimin e detyrueshëm;

d) *Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse* – Kancelarja në detyrë rezulton se është në kushte shëndetësore, të cilat e lejojnë të kryejë detyrën pasi, sipas

raportit mjeko-ligjor të datës 19.03.2019, lëshuar nga Poliklinika Durrës, ka rezultuar “E aftë për punë” dhe nuk rezultojnë të dhëna të mëvonshme për cenimin e kësaj aftësie;

e) *Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.* – Sipas informacionit të përpunuar nga Struktura e Posaçme pranë KLGJ², referuar dokumentacionit të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, rezulton se znj. {...} nuk është e dënuar me vendim penal të formës së prerë. Gjithashtu, nga të dhënat e dosjes personale dhe tërësia e dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit, nuk rezultojnë të dhëna të mëvonshme që të cenojnë përmbushjen këtij kriteri;

f) *Ndaj saj të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji.* Për këtë kriter, gjatë verifikimit, sipas vetëdeklarimit të bërë nga kancelarja në detyrë znj. {...} në jetëshkrimin (CV), të depozituar në dosjen e personelit si dhe shënimet në librezën e punës, u konstatua se ajo ka qenë e punësuar si më poshtë:

(i) për periudhën 18.10.1999 – 06.05.2009 ka ushtruar detyrën e juristes në Filialin Elektrik Berat, më pas, nga data 01.11.2001, “përgjegjëse zyre juridike” në Zonën e Shpërndarjes Elektrike, Berat dhe në datë 01.12.2007 ka kaluar në pozicionin e “Shefes në Degën Juridike” pranë këtij subjekti. Nga shënimet e librezës së punës të administruar në dosjen personale, pasqyrohet se, shkak i përfundimit të marrëdhënies së punës më datë 06.05.2009, është kalimi në institucion tjetër;

(ii) për periudhën 06.05.2009 – 12.01.2015 ka ushtruar detyrën e “Kancelares” në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat. Nga shënimet e librezës së punës të administruar në dosjen personale, në të cilën pasqyrohet se shkak i përfundimit të marrëdhënies së punës pranë këtij institucioni, më datë 12.01.2015, është kalimi në detyrën e kancelares pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës;

(iii) për periudhën 12.01.2015 dhe në vijim, znj. {...} ka ushtruar detyrën e kancelares në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës. Nga vërtetimit nr. 71 prot., datë 27.03.2019, të lëshuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, i depozituar në dosjen personale të kancelares në detyrë, nuk rezulton se ndaj saj të ketë filluar ndonjë procedurë për dhënie mase disiplinore. Nga viti 2019 dhe në vijim, në Këshillin e Lartë Gjyqësor, nuk rezultojnë të dhëna e as janë zhvilluar procedura për marrjen e masave disiplinore ndaj znj. {...}.

B. Për kriteret e veçanta ligjore të pozicionit, sipas nenit 56, pika 1, të ligjit nr. 98/2016

13. Kriteret e parashikuara në nenin 56, pika 1, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar³, përcaktohen si kriteret e veçanta

²Shih shkresën me nr. 5347/142 prot., datë 23.06.2021, të Strukturës së Posaçme për Regjistrimin, Administrimin dhe Përpunimin e Formularëve të Vetëdeklarimit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

³Neni 56, pika 1 e ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar - Kriteret e veçanta për pranimin e nëpunësve civilë gjyqësorë - “1. Për t'u pranuar në provimin e pranimit për formimin fillestar për kancelar, kandidatët duhet të plotësojnë edhe kriteret e veçanta si vijon: a) të jenë diplomuar në drejtësi ose ekonomi në nivelin “Master shkencor” ose të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislativës të arsimit të lartë; b) të kenë përvojë profesionale mbi tetë vjet, nga të cilat së paku tre vjet në pozicione administruese ose pesë vjet në sistemin gjyqësor”

për pranimin e nëpunësve civilë gjyqësorë. Për kancelaren në detyrë, znj. {...}, u verifikuan kriteret e veçanta, si më poshtë:

a) *Të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit.* Në lidhje me këtë kriter, në nenin 56, pika 1, shkronja “a” të ligjit nr. 98/2016 parashikohet se kandidatët për kancelar duhet të jenë diplomuar në drejtësi ose ekonomi në nivelin “Master shkencor” ose të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë. Për këtë kriter, në dosjen personale, kancelarja në detyrë ka depozituar dokumentin “Diplomë”, me nr.6189, datë 10.07.2009, shoqëruar me certifikatë notash, të lëshuar nga Universiteti i Tiranës. Nga të dhënat rezulton se znj. {...} ka filluar studimet në vitin 1995 dhe i ka përfunduar ato në vitin 1999 me sistemin me shkëputje nga puna. Me vendim të Komisionit Shtetëror, datë 08.07.1999, znj. {...} është diplomuar në degën Drejtësi, duke iu dhënë titulli “jurist”.

b) *të ketë përvojë profesionale mbi tetë vjet, nga të cilat së paku tre vjet në pozicione administruese ose pesë vjet në sistemin gjyqësor* – Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen personale, lidhur me marrëdhënien e punësimit, sipas shënimeve në librezën e punës, rezulton se znj. {...} plotëson kriterin e përvojës profesionale të përgjithshme mbi tetë vjet, pasi rezulton që ka punuar si juriste dhe kancelare e gjykatës për më shumë se 22 vjet, si dhe kriterin e përvojës profesionale specifike prej 5 vitesh në sistemin gjyqësor, pasi, vetëm funksionin e kancelares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat dhe më pas në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, e ushtron prej datës 06.05.2009 dhe në vijim, prej me shumë se 12 vjetësh.

C. Për kriterin e pasurisë

14. Për kancelaren në detyrë, znj. {...} u verifikua kriteri i pasurisë, përcaktuar në pikën 1, të nenit 83, të ligjit nr. 98/2016. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të pasurisë për kancelaren në detyrë, u kërkua raportim nga ILDKPKI-ja, e cila ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor raportin: “*Akti i përfundimit të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe të Interesave Privatë të kancelarit në detyrë, {...} pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës*” me nr. 317/25 prot., datë 13.03.2021.

14.1 Sipas raportit të ILDKPKI-së, znj. {...} ka plotësuar dhe depozituar në afatin e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor formularin e deklaratës së pasurisë, si dhe autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë.

14.2. Po ashtu, sipas raportit të ILDKPKI-së, nga kjo e fundit janë kryer kontrollet e plota për pasuritë, asetet dhe interesat e deklaruara, duke konkluduar se për kancelaren në detyrë:

- a) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- b) *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin e krijimit të pasurive;*
- c) *ka mosdeklarim të pasurisë në vite;*

- d) nuk ka kryer deklarin të rremë;
- e) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

14.2.1 Konkluzionet si më sipër, bazohen në rezultatet e kontrollit të kryer nga ILDKPKI, në lidhje me konstatimet sa vijon:

- ✓ *Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, për burimin e likuiditeteve të shtuara gjatë deklaratave Periodike Vjetore 2016 - 2018.*
- ✓ *Vendbanimi i kandidatit tek prindërit e saj, gjatë periudhës 2015 - 2019, nuk vërtetohet me dokumentacion ligjor, si dhe nuk deklarohet si adresë në deklaratat periodike përkatëse. Gjithashtu, mungon dokumentacioni vërtetues, lidhur me burimin financiar të prindërve të kandidatit, me qëllim mbulimin e shpenzimeve të tyre të jetesës, por edhe të familjarëve të saj.*
- ✓ *Mos deklarim në deklaratën Periodike Vjetore 2010, të apartamentit me sipërfaqe 108.6 m², vlerë 93.736 euro dhe pagesave të kryera gjatë kësaj periudhe, në shumën 50.000 euro. Kontrata e porosisë është e datës 4.1.2011.*
- ✓ *Mos përfshirje e detyrimit të deklaruar në shumën 22.236 Euro ndaj shoqërisë "DAED" shpk, për blerjen e apartamentit, në kontratën përfundimtare të shitjes, pasi ky apartament është i regjistruar në hipotekë.*
- ✓ *Mungesë dokumentacioni për vërtetimin e detyrimit të sipërcituar në debitorët e shoqërisë "DAED" shpk.*
- ✓ *Pagesat nga bashkëshorti në shumën 7.500 euro, janë kryer në favor të llogarisë personale të administratorit {...} në BKT dhe jo në emër të kompanisë DAED shpk, me të cilën është nënshkruar kontrata e shitblerjes/marrëveshja e huas.*
- ✓ *Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, lidhur me të ardhurat e përfituara nga vetëpunësimi i b/shortit, deklaruar në shumën 2.000.000 lekë, të cilat nuk konfirmohen nga institucionet përkatëse.*
- ✓ *Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, lidhur me të ardhurat e deklaruara nga b/shorti në shumën 4.000.000 lekë, marrë si bonuse nga shoqëria "Gjergji H", mënyrën e përfitimit, si dhe raportin e punësimit të tij me këtë shoqëri.*
- ✓ *Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, lidhur me burimin e shumave të kredituara në llogarinë e {...}{...} (b/shorti) në ProCredit Bank dhe Tirana Bank, shuma të transferuara periodikisht në llogarinë e shoqërisë "Gjergji H" shpk/shtetasit {...}{...}, gjatë periudhës 2004 - 2009, në total rreth 89.000.000 lekë.*

14.2.2 Bazuar në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 424, datë 12.10.2020, "Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor" (pika 16, seksioni C, kreu IV dhe pika 73, seksioni B, kreu VI), nëpërmjet komunikimin elektronik me datë 06.04.2021, relatori ftoi kancelaren në detyrë, znj.Hysi, për të paraqitur shpjegime dhe çdo dokumentacion mbështetës lidhur me raportin e kontrollit të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë të përgatitur nga ILDKPKI.

14.2.3 Më datë 12.04.2021, me nr. 5678/49 prot, znj.{...}, ka paraqitur pranë Këshillit kundërshtimet lidhur me raportin e ILDKPKI-së, së bashku me dokumentacionin shtesë⁴. Këshilli me shkresën nr. 5678/55 prot., datë 14.04.2021 i ka dërguar pranë ILDKPKI-së shpjegimet dhe dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti, duke kërkuar, në përputhje me parashikimet e pikës 76, seksioni B, kreu VI të vendimit nr. 424/2020, trajtimin dhe përgatitjen e një raporti shtesë lidhur me subjektin.

14.2.4 Në datë 27.04.2021, ILDKPKI ka dërguar raportin shtesë me nr. 2990/40 prot., datë 27.04.2021 për kontrollin e plotë për pasuritë, asetet dhe interesat e deklaruara nga subjekti, duke konkluduar se:

- a) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin,
- b) ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin e krijimit të pasurive;
- c) ka mosdeklarim të pasurisë në vite;
- d) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- e) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

14.2.5 Konkluzionet si më sipër, bazohen në rezultatet e kontrollit të kryer nga ILDKPKI, në lidhje me konstatimet sa vijon:

- ✓ *Mos deklarim në deklaratën Periodike Vjetore 2010, të apartamentit me sipërfaqe 108.6m2, vlerë 93.736 euro dhe pagesave të kryera gjatë kësaj periudhe, në shumën 50.000 euro. Kontrata e porosisë është e datës 4.1.2011.*
- ✓ *Referuar kontratës së shitjes nr. 33177798, datë 3.6.2019, rezulton se çmimi total i blerjes së apartamentit prej 93.736 euro është i likuiduar, sipas kontratës së porosisë të vitit 2011. Nuk është e qartë përfshirja e detyrimit të mbetur prej 22.236 euro, në çmimin e likuiduar, ndërkohë që në regjistrat hipotekorë apartamenti është regjistruar me çmimin përfundimtar të blerjes.*
- ✓ *Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, për pasqyrimin e detyrimit prej 22.236 euro, në debitorët/regjistrat e shoqërisë “DAED” shpk, sipas akt marrëveshjes së huas të datës 3.6.2019.*
- ✓ *Rezulton se pagesat nga bashkëshorti në shumën 7.500 euro, janë kryer në favor të llogarisë personale të administratorit {...} në BKT dhe jo në emër të kompanisë DAED shpk, me të cilën është nënshkruar kontrata e shitblerjes/ marrëveshja e huas.*
- ✓ *Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, lidhur me të ardhurat neto të përfituara nga vetëpunësimi i b/shortit, deklaruar në shumën 2.000.000 lekë. Nga Bashkia Berat konfirmohet vetëm qarkullimi i parashikuar nga aktiviteti privat i b/shortit me NIPT K72823014P.*

⁴ Relacioni është dërguar fillimisht me anë të postës elektronik në datë 10.04.2021.

- ✓ Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, lidhur me të ardhurat e deklaruara nga b/shorti në shumën 4.000.000 lekë, marrë si bonuse nga shoqëria "Gjergji H", mënyrën e përfitimit, si dhe raportin e punësimit të tij, me këtë shoqëri.
- ✓ Mungesë dokumentacioni justifikues, lidhur me burimin e shumave të kredituara në llogarinë e {...}{...} (b/shorti) në ProCredit Bank dhe Tirana Bank, shuma të transferuara periodikisht në llogarinë e shoqërisë "Gjergji H" shpk/shtetasit {...}{...}, gjatë periudhës 2004 – 2009, në total rreth 89.000.000 lekë.

14.2.6 Lidhur me dy konstatimet e para të raportit fillestar, pas administrimit dhe vlerësimit të shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit të paraqitur prej tij, ILDKPKI, në raportin shtesë konkludon se: *"..KLGJ, me shkresën nr. 2990/29 prot., dt. 15.4.2021, përcjell shpjegime shtesë të kandidatës, si vijon: Lidhur me mungesën e dokumentacionit justifikues ligjor, për burimin e likuiditeteve të shtuara gjatë deklaratave Periodike Vjetore 2016 - 2018, deklararon se burimi i vetëm i krijimit të pasurive që ajo dhe bashkëshorti kanë pasur, kanë qenë të ardhurat nga pagat. Gjithashtu, gjatë deklaratave PV2016 - PV2018, ka pasur të ardhura nga vajza Arlina{...} në formë burse, si dhe nga dhënia me qira e pasurive të paluajtshme. Prindërit e saj, kanë të ardhura mëse të mjaftueshme, të përfituara në emigracion, transferuar nga bankat greke në bankat shqiptare mbas ardhjes së tyre për të jetuar në Shqipëri. Lidhur me vendbanimin tek prindërit e saj, gjatë periudhës 2015 - 2019, i cili nuk vërtetohet me dokumentacion ligjor, si dhe nuk deklarohet si adresë në deklaratat periodike përkatëse, kandidati deklaroi se vetëm ajo ka qëndruar tek shtëpia e prindërve në Durrës, për shkak të punës që kishte nga dita e hënë deri të shtunën dhe jo familjarët e tjerë (bashkëshorti dhe dy fëmijët të cilët jetojnë në Tiranë). Kjo ishte arsyeja e mosdeklarimit të adresës tjetër të banimit....Në analizë të sqarimeve shtesë dhe dokumentacionit të paraqitur nga kandidati pranë KLGJ, rezultoi: Ka paraqitur dokumentacion lidhur me të ardhurat e prindërve të saj si dhe ka dhënë shpjegime lidhur me shpenzimet e jetesës"* (shih raportin shtesë nr. 2990/40 prot., datë 27.04.2021, faqe 4 - 5).

14.2.7 Lidhur me tre konstatimet e tjera vijuese, pas administrimit dhe vlerësimit të shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit të paraqitur prej tij, ILDKPKI, në raportin shtesë konkludon se: *"..KLGJ, me shkresën nr. 2990/29 prot., dt. 15.4.2021, përcjell shpjegime shtesë të kandidatës si vijon: Lidhur me mosdeklarimin në deklaratën Periodike Vjetore 2010, të apartamentit me sip. 108.6 m², vlerë 93.736 euro dhe pagesave të kryera gjatë kësaj periudhe, në shumën 50.000 euro, kandidati deklaroi se ka patur një marrëdhënie mirëbesimi me shoqërinë DAED shpk, e cila nuk hynte në llojin marrëdhënieve për të cilat ekzistonte detyrimi i deklarimit, pasi nuk ishte përcaktuar përfundimisht objekti pasuri e paluajtshme dhe as të drejtat reale mbi të (objekti akoma nuk ekzistonte) dhe si pasojë, as pagesat e kryera shoqërisë DAED shpk. Për më tepër, këto pagesa janë konsideruar si shpenzime të kryera, të cilat nuk kishte si t'i deklaronte për shkak të mungesës së legjislacionit në atë periudhë. Me arritjen e marrëveshjes së materializuar me shoqërinë ndërtimore në datë 4.1.2011, e pasqyroi duke e deklaruar në deklaratën Periodik Vjetor 2011. Gjithashtu, kandidati thekson se për këtë pjesë të vlerësimit të ILDKPKI, është konsideruar e pabazuar në vendimin gjyqësor të formës së prerë (nr. 2545, datë 7.6.2017, i Gjykatës*

Administrative Tiranë). Lidhur me mos përfshirjen e detyrimit të deklaruar në shumën 22.236 euro, ndaj shoqërisë "DAED" shpk, për blerjen e apartamentit, në kontratën përfundimtare të shitjes, pasi ky apartament është i regjistruar në hipotekë, kandidati deklaroi se për këtë konkluzion, nuk ka një veprim ose mosveprim të kryer prej saj, në kundërshtim me ligjin. Lidhur me mungesën e dokumentacionit, për vërtetimin e detyrimit të sipërcituar, prej 22.236 euro, në debitorët e shoqërisë "DAED" shpk., kandidati nuk ka paraqitur dokumentacion provues ligjor për ekzistencën e këtij detyrimi në dokumentet fiskal të shoqërisë "DAED" shpk. Në analizë të sqarimeve shtesë të paraqitur nga kandidati pranë KLGJ, (i cili nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues) rezultoi: - Mosdeklarim në deklaratën Periodike Vjetore 2010, të apartamentit me sip. 108.6 m2, vlerë 93.736 euro dhe pagesave të kryera gjatë kësaj periudhe, në shumën 50.000 euro. Kontrata e porosisë është e datës 4.1.2011. - Referuar kontratës së shitjes nr. 3317/798, datë 3.6.2019, rezultoi se çmimi total i blerjes së apartamentit prej 93.736 euro është i likuiduar sipas kontratës së porosisë të vitit 2011. Nuk është e qartë përfshirja e detyrimit të mbetur prej 22.236 euro, në çmimin e likuiduar, ndërkohë që në regjistrat hipotekorë apartamenti është regjistruar me çmimin përfundimtar të blerjes. - Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, për pasqyrimin e detyrimit prej 22.236 euro, në debitorët/regjistrat e shoqërisë "DAED" shpk, sipas akt marrëveshjes së huas së datës 3.6.2019" (shih raportin shtesë nr. 2990/40 prot., datë 27.04.2021, faqe 9 - 10).

14.2.8 Lidhur me konstatimin e gjashtë, pas administrimit dhe vlerësimit të shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit të paraqitur prej tij, ILDKPKI, në raportin shtesë konkludoi se: *"..Referuar mandat pagesave të paraqitura gjatë periudhës 2010 - 2011, janë paguar në total 64.000 euro, gjatë periudhës 2012 - 2014 paguar shuma 7.500 euro dhe pjesa e papaguar prej 22.236 euro është deklaruar detyrim ndaj shoqërisë së ndërtimit, që me marrëveshjen e huas datë 3.6.2019, ka kaluar nga detyrim i papaguar në detyrim huaje ndaj shoqërisë "DAED" shpk. Rezultoi se pagesat nga bashkëshorti, në shumën 7.500 euro, janë kryer në favor të llogarisë personale të administratorit {...}, në BKT dhe jo në emër të kompanisë DAED shpk, me të cilën është nënshkruar kontrata e shitblerjes/marrëveshja e huas. KLGJ, me shkresën nr. 2990/29 prot., dt. 15.4.2021, përcjell shpjegime shtesë të kandidatit si vijon: Lidhur me pagesat e kryera nga bashkëshorti, në shumën 7.500 euro, në favor të llogarisë personale të administratorit {...}, në BKT dhe jo në emër të kompanisë DAED shpk, me të cilën është nënshkruar kontrata e shitblerjes marrëveshja e huas, kandidati deklaroi se ILDKPKI duhet t'i bëjë me dije kandidatit normën ligjore, që përcakton detyrimin e kandidatit për të mos kryer një veprim të tillë. Në analizë të sqarimeve shtesë të paraqitur nga kandidati pranë KLGJ, konkluzioni mbetet i njëjtë." (shih raportin shtesë nr. 2990/40 prot., datë 27.04.2021, faqe 11 - 13).*

14.2.9 Lidhur me tre konstatimet e fundit, pas administrimit dhe vlerësimit të shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit të paraqitur prej tij, ILDKPKI, në raportin shtesë konkludoi se: *"..KLGJ, me shkresën nr. 2990/29 prot., dt. 15.4.2021, përcjell shpjegime shtesë të kandidatit si vijon: Lidhur me mungesën e dokumentacionit justifikues ligjor, lidhur me të ardhurat e përfuturara nga vetëpunësimi i b/shortit, deklaruar në shumën 2.000.000 lekë, të cilat nuk konfirmohen nga*

institucionet përkatëse, kandidatja deklaron se ILDKPKI duhet të kishte marrë në konsideratë se nuk ka dokument zyrtar që konfirmon marzhin e fitimit nga ushtrimi i aktivitetit privat të bashkëshortit në atë periudhë. Gjithashtu, kandidati thekson se për këtë pjesë të vlerësimit të ILDKPKI, është konsideruar e pabazuar në vendimin gjyqësor të formës së prere (nr.2545 datë 7.6.2017 i Gjykatës Administrative Tiranë). Lidhur me mungesën e dokumentacionit justifikues ligjor, për të ardhurat e deklaruara nga b/shorti, në shumën 4.000.000 lekë, marrë si bonuse nga shoqëria "Gjergji H", mënyrën e përfitimit, raportin e punësimit të tij me këtë shoqëri, si dhe mungesën e dokumentacionit justifikues për burimin e shumave të kredituara, në llogarinë e {...}{...} (b/shorti) në ProCredit Bank dhe Tirana Bank, shuma të transferuara periodikisht në llogarinë e shoqërisë "Gjergji H" shpk/shtetasit {...}{...}, gjatë periudhës 2004 – 2009, në total rreth 89.000.000 lekë, kandidati deklaron: burimi financiar i shumave të transferuara periodikisht nga bashkëshorti në llogari të shoqërisë "Gjergji H" shpk, janë nga aktiviteti import eksport tregti me shumicë, ku administrator është vëllai i tij {...}{...}. Kandidati dhe bashkëshorti nuk kanë qenë subjekt deklarues në këtë periudhë dhe nuk janë thirrur nga asnjë organ ligjzbatues për veprime të kundraligjshme. Në analizë të sqarimeve shtesë të paraqitur nga kandidati pranë KLGJ, (i cili nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues) rezulton: - Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, lidhur me të ardhurat neto të përfituara nga vetëpunësimi i b/shortit, deklaruar në shumën 2.000.000 lekë. Nga Bashkia Berat konfirmohet vetëm qarkullimi i parashikuar nga aktiviteti privat i b/shortit, me NIPT K72823014P. - Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, lidhur me të ardhurat e deklaruara nga b/shorti në shumën 4.000.000 lekë, marrë si bonuse nga shoqëria "Gjergji H", mënyrën e përfitimit, si dhe raportin e punësimit të tij me këtë shoqëri. - Mungesë dokumentacioni justifikues, lidhur me burimin e shumave të kredituara në llogarinë e {...}{...} (b/shorti) në ProCredit Bank dhe Tirana Bank, shuma të transferuara periodikisht në llogarinë e shoqërisë "Gjergji H" shpk/shtetasit {...}{...}, gjatë periudhës 2004 - 2009, në total rreth 89.000.000 lekë." (shih raportin shtesë nr. 2990/40 prot., datë 27.04.2021, faqja 19).

14.2.10 Bazuar në raportin shtesë, të dërguar nga ILDKPKI-ja, Relatori, bazuar në Vendimin nr. 424/2020 (pika 16, seksioni C, kreu IV dhe pika 73, seksioni B, kreu VI), nëpërmjet komunikimit elektronik, në datë 30.04.2021, ftoi kancelaren në detyrë, znj. {...}, për të paraqitur shpjegime dhe çdo dokumentacion mbështetës lidhur me raportin shtesë të kontrollit të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave privatë të përgatitur nga ILDKPKI.

14.2.11 Më datë 05.05.2021, depozituar me nr. 5678/73 prot., znj. {...} ka paraqitur pranë Këshillit kundërshtimet lidhur me raportin shtesë të ILDKPKI-së, së bashku me dokumentacionin shtesë.

14.2.12 Në shpjegimet me shkrim, lidhur me pikën e parë të raportit fillestar, znj. {...} parashtron se: "Duke qenë se edhe nga ky konstatim është qartësuar edhe vet ILDKPKI përsëri shprehet se "deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin", ku tani me në asnjë prej te gjitha rubrikave nuk ka edhe nuk kuptohet qarte në cilin rast deklarimi nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin ??, në këto kushte kërkoj që të mos merret në konsideratë nga ana juaj." (shih Relacioni shpjegues shtesë, datë 05.05.2021, faqja 2).

14.2.13 Lidhur me konkluzionin e dytë dhe të tretë të raportit fillestar, znj. {...}, parashtrohet se: “Të gjitha këto konstatime i përkasin një pasurie të krijuar përpara fillimit të detyrës time si kancelare, konstatime të cilat janë konsideruar te pabazuara me vendim gjyqësor te formës se prerë. (Vendimi nr.2545 date 07.06.2017 i Gjykatës Administrative te Shkallës Parë Tiranë). Në asnjë prej rubrikave të mësipërme nuk është përcaktuar se nuk ka dokument ligjor justifikues për pasurinë shtesë prej rreth 4.407.000 lekë/neto të krijuar gjatë ushtrimit të detyrës time si kancelare . Edhe ai konstatim i shprehur në Aktin 317/25 Prot., datë 13.03.2021 ku konkretisht thekson: Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, për burimin e likuiditeteve të shtuara gjatë deklaratave Periodike Vjetore 2016 – 2018, ILDKPKI pranon në Raportin shtesë të datës 23.04.2021, duke u shprehur se: - Në analizë të sqarimeve shtesë dhe dokumentacionit të paraqitur nga kandidati pranë KLGJ, rezultoi: Ka paraqitur dokumentacion lidhur me të ardhurat e prindërve të saj si dhe ka dhënë shpjegime lidhur me shpenzimet e jetesës. Ne këto kushte kërkoj që të mos merret në konsideratë nga ana juaj konstatimi i dytë dhe i tretë i ILDKPKI, në Aktin 317/25 Prot., datë 13.03.2021, si dhe Raportin shtesë të datës 23.04.2021 . Të gjitha këto konstatime dhe gjetje të mësipërme janë konsideruar te pabazuara me vendim gjyqësor te formës se prerë. (Vendimi nr 2545 date 07.06.2017 i Gjykatës Administrative te Shkallës Parë Tiranë).... Në këtë aspekt, Gjykata Kushtetuese çmon se gjëja e gjykuar përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por dhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit me kusht, që të jenë kryer me qëllim të dhënies së vendimit gjyqësor dhe t’i përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj. Duke qenë se edhe këto dy konstatime nuk arrihen të kuptohen qartë, dhe bien në kundërshtim të hapur me parimin e Gjësë së Gjykuar kërkoj që të mos merren në konsideratë nga ana juaj”. (shih Relacioni shpjegues shtesë, datë 05.05.2021, faqja 3,4,5).

14.2.14 Në lidhje me konstatimin e mos deklarimit në deklaratën Periodike Vjetore 2010, të apartamentit me sipërfaqe 108.6 ml, vlerë 93.736 euro dhe pagesave të kryera gjatë kësaj periudhe, në shumën 50.000 euro, kancelarja në detyrë deklaroi se: “ .. ishte në kërkim të një apartamenti për familjen e saj, pati një marrëdhënie mirëbesimi verbale me shoqërinë “DAED” sh.p.k, me administrator {...} {...}, djalin e hallës time, i cili u angazhua në gjetjen e alternativave të tjera të banimit, në kushtet kur po ndërtonte edhe pallate të tjera Durrës , Tiranë, Berat , Sarandë. Sipas kandidatit, kjo lloj marrëdhënie nuk hynte në llojin e marrëdhënieve për të cilat ekzistonte detyrimi i deklarimit, pasi nuk ishte përcaktuar përfundimisht objekti pasuri e paluajtshme dhe as të drejtat reale mbi të dhe, si pasojë, as pagesat e kryera shoqërisë “DAED “ sh.p.k. Për më tepër, sipas saj, këto pagesa janë konsideruar si shpenzime të kryera, të cilat nuk kishte si ti deklaronte për shkak të mungesës së legjislacionit në atë periudhë. ...Kandidati deklaroi nuk ka pasur një marrëveshje të materializuar me shoqërinë ndërtimore dhe as kishte fituar të drejta reale të pronësisë, sepse objekti akoma nuk ekzistonte. Edhe një herë duhet të theksoj se kandidati me arritjen e marrëveshjes së materializuar me shoqërinë ndërtimore në datë 04.01.2011 e pasqyroi këtë marrëveshje duke e deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2011. Gjithashtu theksojmë se:

rezulton se nga përmbajtja në tërësi e tij ne aktin përfundimtar të kontrollit të ILDKPKI-së, del qarte se edhe për këtë pjesë të vlerësimit ILDKPKI-së, është konsideruar e pabazuar me vendim gjyqësor të formës së prerë. (Vendimi nr 2545 date 07.06.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës Parë Tiranë).” (shih Relacioni shpjegues shtesë, datë 05.05.2021, faqja 5,6).

14.2.15 Në lidhje me konstatimin e mos përfshirjes së detyrimit të deklaruar në shumën 22.236 Euro, ndaj shoqërisë "DAED" shpk, për blerjen e apartamentit, në kontratën përfundimtare të shitjes, pasi ky apartament është i regjistruar në hipotekë, kancelarja në detyrë shpjegon se: *“ILDKPKI, kur konstaton, apo krijon bindjen se kandidati nuk ka përmbushur një detyrim ligjor të caktuar, duhet t’ia bëjë me dije këtë mangësi apo situatë subjektit, nëse ky element konsiderohet se mund të çojë drejt prezumimit të vendosjes së një mase disiplinore apo arritjen e një konkluzioni, në mënyrë që kandidati të këtë mundësinë dhe të ushtrojë të drejtën që ia njeh Kushtetuta për të provuar të kundërtën. Ky moment procedural mjaft i rëndësishëm, duhet të jetë i qartë dhe i komunikuar drejtpërdrejt kandidatit, pikërisht në garantim të së drejtës së tij për të paraqitur prova dhe argumente për t’u dëgjuar drejtësisht e për t’u mbrojtur në mënyrë efektive ndaj këtyre gjetjeve/”akuzave” që prezumojnë. Vetëm duke vepruar në këtë mënyrë kandidati mund të realizojë të drejtën e tij të parashikuar në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, për t’u dëgjuar e mbrojtur, në kuadër të një procesi të rregullt sipas nenit 6/1 të KEDNJ. Në nenin 87 i ligjit nr. 44/2015, i titulluar “Njoftimi dhe e drejta për t’u dëgjuar para marrjes së vendimit përfundimtar” parashikohet se organi publik, përpara se të marrë vendimin përfundimtar, njofton palën për të drejtën e saj për t’u dëgjuar. Ndër të dhënat që duhet të përmbajë ky njoftim, sipas paragrafit 2 të këtij neni, është edhe parashikimi i germës “ç” të tij, cila detyron organin publik t’i bëjë prezent palës provat e administruara, rezultatet e hetimit si edhe rezultatet e pritshme të procedurës administrative dhe motivimin përkatës. Në zbatim të kuptimit të këtij rregulli, ILDKPKI, para se t’i japë mundësinë të dëgjohet subjektit të rivlerësimit, duhet t’i bëjë prezent, përveç rezultateve të hetimit, edhe “rezultatet e pritshme të procedurës administrative”, që do të thotë, praktikisht, t’i bëjë me dije se cila është situata e gjetjeve të saj që mund të shkaktojnë arritjen e një konkluzioni ne rastin konkret të gabuar . Në rastin konkret nuk ka një veprim ose mosveprim (i kandidatit) i kryer në kundërshtim me ligjin.” (shih Relacioni shpjegues shtesë, datë 05.05.2021, faqja 6,7).*

14.2.16 Në lidhje me konstatimin për mungesë dokumentacioni për vërtetimin e detyrimit në debitorët e shoqërisë "DAED" shpk, kancelarja në detyrë deklaroi se: *“... edhe në këtë konkluzion të gabuar ILDKPKI, kur konstaton, apo krijon bindjen se kandidati nuk ka përmbushur një detyrim ligjor të caktuar, duhet t’ia bëjë me dije këtë mangësi apo situatë subjektit, nëse ky element konsiderohet se mund të çojë drejt prezumimit të vendosjes së një mase disiplinore apo arritjen e një konkluzioni, në mënyrë që kandidati të këtë mundësinë dhe të ushtrojë të drejtën që ia njeh Kushtetuta për të provuar të kundërtën. Ky moment procedural mjaft i rëndësishëm, duhet të jetë i qartë dhe i komunikuar drejtpërdrejt kandidatit, pikërisht në garantim të së drejtës së tij për të paraqitur prova dhe argumente për t’u dëgjuar drejtësisht e për t’u mbrojtur në mënyrë efektive ndaj këtyre gjetjeve/”akuzave” që prezumojnë. Vetëm duke vepruar në këtë mënyrë kandidati*

mund të realizojë të drejtën e tij të parashikuar në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, për t'u dëgjuar e mbrojtur, në kuadër të një procesi të rregullt sipas nenit 6/1 të KEDNJ.” (shih Relacioni shpjegues shtesë, datë 05.05.2021, faqja 7).

14.2.17 Në lidhje me pagesën e shumës 7.500 euro, kancelarja në detyrë deklaroi se: *“..janë kryer ne favor të llogarisë personale të administratorit {...} në BKT dhe jo në emër të kompanisë DAED shpk, me të cilën është nënshkruar kontrata e shitblerjes/marrëveshja e huas.çdo gjetje e ILDKPKI -së duhet të shoqërohet edhe me dispozitën ligjore që ka shkelur kandidati. Psh, nëse ILDKPKI thotë se për kandidatin rezulton se pagesat nga bashkëshorti në shumën 7.500 euro, janë kryer ne favor te llogarisë personale të administratorit {...} në BKT dhe jo te emër të kompanisë DAED shpk, me te cilën është nënshkruar kontrata e shitblerjes/marrëveshja e huas, duhet t'i bëjë me dije kandidatit normën ligjore që përcakton detyrimin e kandidatit për të mos kryer një veprim të tillë. Njoftimi i “gjetjeve” është moment procedural shumë i rëndësishëm, i cili duhet të jetë i qartë . Gjithashtu, me e-mail in e datës 8.2.2021, kandidati ka paraqitur pranë inspektorit të ILDKPKI një relacion shpjegues në të cilën deklaroi se: Në lidhje me likuidimin e një apo dy prej faturave ne BKT në emër të administratorit {...} {...} të firmës DAED sh.p.k të deklaruar në deklaratat periodik të viteve përkatëse sqaroj se mund të jetë një lapsus i BKT pasi në këtë bankë janë edhe llogaria e administratorit edhe llogaria e firmës. Në lidhje me këtë fakt nuk ka pretendim nga firma DAED sh.p.k dhe as nga administratori z. {...} {...}. Edhe për këtë konkluzion: rezulton se nga përmbajtja në tërësi e tij ne aktin përfundimtar të kontrollit të ILDKPKI-së, del qarte se edhe për këtë pjesë të vlerësimit ILDKPKI-së, është e pakuptueshme: “Gjetja” e cila në këtë kontekst është një veprim ose mosveprim (i kandidatit) i kryer në kundërshtim me ligjin e cila konsiderohet se mund të çojë drejt prezumimit të vendosjes së masës disiplinore. Pra edhe për këtë gjetje ILDKPKI duhet të shoqërohet edhe me dispozitën ligjore që ka shkelur kandidati.” (shih Relacioni shpjegues shtesë, datë 05.05.2021, faqja 8).*

14.2.18 Në lidhje me konstatimin për mungesën e dokumentacionit justifikues ligjor, lidhur me të ardhurat e përfituara nga vetëpunësimi i b/shortit, deklaruar ne shumën 2.000.000 leke, kancelarja në detyrë deklaroi se: *“Bashkia Berat, me shkresën nr. 317/24 prot, dt. 3.12.2020, konfirmon se subjekti {...}{...}, me NIPT K728230I4P, me adrese lagja “30 Vjetori” është regjistruar pranë kësaj Bashkie dhe është çregjistruar më datë 29.10.2008. Subjekti nuk ka kryer deklarim të qarkullimit dhe për këtë arsye është parashikuar nga Drejtoria e Taksave për vitin 2007 qarkullim vjetor 0-2 milion leke dhe për vitin 2008 qarkullim 2-3 milion lekë. ...Duhet te theksojmë se edhe për këtë konkluzion: rezulton se nga përmbajtja në tërësi e tij ne aktin përfundimtar të kontrollit të ILDKPKI-së, del qartë se edhe për këtë pjesë të vlerësimit ILDKPKI-së, është konsideruar e pabazuar me vendim gjyqësor të formës së prerë. (Vendimi nr 2545 date 07.06.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës Parë Tiranë). (shih Relacioni shpjegues shtesë, datë 05.05.2021, faqja 8, 9).*

14.2.19 Në lidhje me konstatimin për mungesën e dokumentacionit justifikues ligjor, lidhur me të ardhurat e deklaruar nga b/shorti në shumën 4.000.000 lekë, marrë si bonuse nga shoqëria "Gjergji H", mënyrën e përfitimit, si dhe raportin e punësimit të tij, me këtë shoqëri, si dhe me burimin e

shumave të kredituara në llogarinë e {...}{...} (b/shorti) në ProCredit Bank dhe Tirana Bank, shuma të transferuara periodikisht në llogarinë e shoqërisë "Gjergji H" shpk/shtetasit {...}{...}, gjatë periudhës 2004 – 2009, në total rreth 89.000.000 lekë, kancelarja në detyrë deklaroi se: *“Për të dyja këto konkluzione ILDKPKI është kontradiktore në gjetjet e saj sepse shprehet se ka mangësi dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me të ardhurat e deklaruara nga b/shorti në shumën 4.000.000 leke, marrë si bonuse dhuratë nga shoqëria vëllai i bashkëshortit të kandidatit njëkohësisht edhe administrator "Gjergji H" sh.p.k dhe më pas shprehet se duhet dokumentacion justifikues lidhur me burimin e shumave të kredituara në llogarinë e {...}{...} (b/shorti) në ProCredit Bank dhe Tirana Bank, shuma të transferuara periodikisht në llogarinë e shoqërisë "Gjergji H" shpk/shtetasit {...}{...}, gjatë periudhës 2004 - 2009, në total rreth 89.000.000 lekë. Burimi i shumave të kredituara në llogarinë e {...}{...} (b/shorti) në ProCredit Bank dhe Tirana Bank, shuma të transferuara periodikisht në llogarinë e shoqërisë "Gjergji H" shpk/shtetasit {...}{...}, gjatë periudhës 2004 - 2009, në total rreth 89.000.000 lekë janë nga aktiviteti tregtar import – eksport – tregti me shumicë ku administrator është edhe vëllai bashkëshortit të kandidatit z. {...}{...}. Kandidati dhe bashkëshorti nuk kanë qenë subjekt deklarues për këtë periudhë dhe nuk janë thirrur nga asnjë organ ligjzbatues për veprime të kundërligjshme, përkundrazi kanë gëzuar mirënjohje dhe respekt nga komuniteti për shkak se janë dy njerëz që jetojnë dhe punojnë me ndershmëri . Për më tepër aktiviteti tregtar i shoqërisë Gjergji H sh.p.k është një aktivitet i ligjshëm dhe rezulton përsëri e provuar edhe nga ILDKPI se sipas: Ekstrakt historik i regjistrimit tregtar të shoqërisë "Gjergji H", me administratore shtetasen {...}{...} dhe ortak i 50% të kuotave shtetasi {...}{...}. Kapitali i shoqërisë 50.000.000 lekë. Referuar historikut të shoqërisë, kapitali është shtuar në datë 28.2.2005, sipas vendimit nr. 25167/2, në vlerën 39.900.000 lekë dhe në datë 28.9.2005, sipas vendimit nr. 25167/4, në vlerën 10.000.000 leke. Gjithashtu, shtetasi {...}{...} ka qenë administrator i shoqërisë deri me datë 3.2.2020. Konkretisht në një nga rubrikat për të mos i përmendur të gjitha ILDKPKI shprehet : Levizjet e llogarisë në emër të {...}{...} pranë ProCredit Bank, gjatë periudhës 16.11.2004 - 25.1.2009. Evidentohen depozitime cash periodike në llogari nga {...}{...} për vitin 2004, në shumën totale 3.170.000 lekë, për vitin 2005 në shumën 21.840.000 leke, për vitin 2006 në shumën 21.520.000 leke, për vitin 2007 në shumën 12.000.000 lekë. Të gjitha vlerat e depozituara nga {...}{...} në llogarinë e tij janë transferuar brenda ditës dhe në të njëjtën vlerë të depozituar, në favor të llogarisë në emër të shtetasit {...}{...}, njëkohësisht administrator i Gjergji H shpk. Nuk evidentohen fonde të përdorura (tërheqje cash apo transferime bankare) personalisht prej shtetasit {...}{...}. (Sqaroj se nuk ka pasuri të krijuara me këto shuma, të gjitha i përkasin shoqërisë “Gjergji H” shpk, bashkëlidhur ekstraktin e shoqërisë.)” (shih Relacioni shpjegues shtesë, datë 05.05.2021, faqja 9, 10).*

14.12.20 Mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor⁵, ILDKPKI, në datë 18.05.2021, ka dërguar në format elektronik (CD) dosjen e kontrollit të plotë për kancelaren në detyrë {...}. Duke krahasuar të dhënat e përshkruara në Raportin e ILDKPKI-së, (sipas CD) si dhe pretendimeve me shkrim të znj. {...}, të shoqëruara me dokumentacion nga vetë ajo rezulton se nuk konstatohet

⁵ Shkresa nr. 5678/79 prot., datë 11.05.2021 e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

mangësi në deklarin e kryer nga kancelarja në detyrë dhe deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin.

15. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kancelaren në detyrë znj. {...} dhe personat e lidhur u kërkua informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve⁶ dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave⁷.

15.1 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me shkresën nr. 22524/2 prot., datë 04.12.2020, protokolluar në Këshill me nr. 5347/11 prot., datë 07.12.2020, ka përcjellë informacionin e kërkuar, për znj. {...} dhe personat e lidhur, sipas të cilit znj. {...} nuk rezulton e regjistruar në organet tatimore. Për të administrohen vetëm të dhënat e ekstraktit historik të punonjësit dhe lista e personave/tatimpagueseve të lidhur. Për personin e lidhur bashkëshortin z. {...}{...} nga informacioni i përcjellë, nuk rezultojnë të dhëna për regjistrimin e tij në organin tatimor.

15.2 Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me shkresën nr. 21636/1 prot, datë 14.12.2020, protokolluar në Këshill me 5347/13 prot, datë 15.12.2020, ka përcjellë informacionin e kërkuar nga KLGJ. Në këtë informacion për znj. {...} dhe personin e lidhur bashkëshortin z. {...}{...} nuk jepet ndonjë e dhënë me karakter pasuror.

16. Të dhënat e dërguara përmes informacioneve respektive nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave u ballafaquan me të dhënat sipas Raportit të ILDKPKI-së, duke u vlerësuar se nuk kishte vend për t'i kërkuar ILDKPKI-së bërjen e një kontrolli shtesë. Po ashtu, referuar të dhënave të përshkruara në Raportin e ILDKPKI-së, të nxjerra nga dokumentacioni i paraqitur nga vetë kancelarja në detyrë, si dhe ai i administruar nga korrespondenca me subjekte shtetërore dhe private, dokumentacion që evidentohet hollësisht në Raport, sikundër dhe analizës financiare të bërë nga ky organ publik, përgjegjës për kontrollin e deklaramit të pasurive dhe konfliktit të interesave sipas Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, "Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik", i ndryshuar, nuk u konstatua mangësi në raportim.

17. Nga verifikimi i kriterit të pasurisë për kancelaren në detyrë znj. {...}, janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet për ekzistencën e shkaqeve të kualifikimit ose skualifikimit të saj. Konkretisht, të dhëna në lidhje me:

- a) plotësimin, depozitimin ose jo nga kancelarja në detyrë, të formularit të deklaratës së pasurisë;
- b) plotësimin, depozitimin ose jo nga kancelarja në detyrë, të nënshkruara, të autorizimeve të kërkuara për verifikimin e pasurisë;
- c) burimet financiare të kancelares në detyrë dhe justifikimin ose jo të pasurisë së saj;

⁶ Shkresa nr. 5347/5 prot., datë 19.11.2020 e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

⁷ Shkresa nr. 5347/4 prot., datë 19.11.2020 e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

ç) plotësinë, vërtetësinë dhe saktësinë ose jo, të deklaramit të pasurisë, aseteve ose të interesave private, të detyrueshme për t'u deklaruar.

18. Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i mbledhur në datë 18.11.2021, vendosi t'i komunikojë kancelares në detyrë znj. {...} për gjetjet paraprake në procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të pozicionit, pasurisë dhe figurës, lidhur me kriterin e pasurisë.

18.1 Më datë 01.12.2021, znj. {...}, ka dërguar nëpërmjet komunikimit elektronik kundërshtimet e saj lidhur me gjetjet paraprake të Komisionit, si më poshtë:

18.1.1 *Në lidhje me konkluzionin për mosdeklarimin në DPV për vitin 2010 të pasurisë apartamentit me sip. 108.6 ml, vlere 93.736 euro dhe pagesave të kryera gjatë kësaj periudhe, në shumën 50.000 euro është paraqitur pranë inspektorit të ILDKPKI-së një relacion shpjegues. Kjo gjetje i përket periudhës së deklaramit për të cilën është kontrolluar më herët kontroll nga ILDKPKI dhe gjetjet janë vlerësuar jo të mbështetura në prova dhe në ligj me vendim gjyqësor të formës së prerë i cili i jep prioritet parimit të sigurisë juridike e cila presupozon, veç të tjerash, besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Ligji duhet të ofrojë siguri dhe vijnësi me qëllim që individët të mund të kryejnë veprimet në mënyrën e duhur. Në rastin konkret, deklarimi i apartamenti në fjalë është detyrim i cili rezulton të jetë përmbushur dhe gjatë kësaj periudhe nuk ka ndryshuar asnjë fakt dhe rrethanë apo të kenë lindur fakte dhe rrethana të reja, të cilat mund të justifikonin kufizimin e parimit të sigurisë juridike.*

18.1.2 *Në lidhje me gjetjen se pagesat nga bashkëshorti në shumën 7.500 euro, janë kryer në favor të llogarisë personale të administratorit z. {...} {...} në BKT dhe jo në emër të Shoqërisë "DAED" shpk, kjo gjetje i përket një pasurie të krijuar gjatë periudhës së kontrolluar me herët nga ILDKPKI dhe për të cilën nuk janë evidentuar gjetje që ngarkojnë me përgjegjësi subjektin sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë, në kontekstin e çështjes në shqyrtim, nënkupton që, në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim". "Në lidhje me pagesën e shumës 7.500 euro, nuk ka pretendime nga Shoqëria "DAED" sh.p.k dhe as nga administratori z. {...} {...}...".*

18.1.3 *Në lidhje me gjetjen referuar kontratës së shitjes nr. 33177798, datë 03.06.2019, ku rezulton se çmimi total i blerjes së apartamentit prej 93.736 euro është i likuiduar, sipas kontratës së porosisë të vitit 2011, ku nuk është e qartë përfshirja e detyrimit të mbetur prej 22.236 euro, në çmimin e likuiduar, ndërkohë që në regjistrat hipotekorë apartamenti është regjistruar me çmimin përfundimtar të blerjes, sqarohet se kjo kontratë shitblerje është lidhur me firmën DAED , pa*

shlyer detyrimin e mbetur prej 22.236 (njetedymijedyqindetridhjetegjashte) euro. Ky detyrim në marrëveshje me administratorin e firmës DAED, (për shkak dhe të marrëdhënies së posaçme, administratori është djali i hallës i subjektit znj. {...}) ka kaluar në një hua, e cila merret përsipër të paguhet në një moment të dytë në një afat të pacaktuar. Është sqaruar gjithashtu se në vitin 2019 kancelari në detyrë ka aplikuar dhe është pranuar për ndjekje të studimeve pasuniversitare në Kanada . Gjithashtu në këtë periudhë konkretisht 11 prill 2019, i është pranuar edhe leja e qendimit në Quebec Kanada. Duke qene se do te largoheshin familjarisht për në Kanada kanë të regjistruar apartamentin e prenotuar ndonëse nuk kishin shlyer të gjithë detyrimin.

18.1.4 Në lidhje me gjetjen mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, për pasqyrimin e detyrimit prej 22.236 euro, në debitorët/regjistrat e shoqërisë “DAED” shpk, sipas akt marrëveshjes së huas të datës 03.06.2019”, sqarohet se marrëdhënia e krijuar midis subjektit deklarues dhe shoqërisë ‘DAED’ sh.p.k, me aktmarrëveshjen e datës 03.06.2019, nuk është një marrëdhënie juridike shitblerjeje e një pasurie, por një kontratë huaje, ku subjekti është në cilësinë e huamarresit dhe shoqëria, në cilësinë e huadhënësit. Pagesat do te kryhen në të ardhmen, si rrjedhojë kanë një regjim si juridik dhe kontabël të ndryshëm nga shitblerja. Pagesat që do të kryhen nga kjo marrëdhënie nuk mund të pasqyrohen në librat e shitblerjeve të shoqërisë ndërtuese dhe trajtohen ndryshe nga legjislacioni tatimor në fuqi. Aktmarrëveshja e datës 03.06.2019 është një parashikim i palëve për mënyrën e shlyerjes së çmimit për këstet e mbetura pa paguar, që do të ndodhë në të ardhmen. Palët në një marrëdhënie kontraktore udhëhiqen nga parimet e mirëbesimit në zbatimin e detyrimeve kontraktore, por ato mbeten përsëri të lira të ushtrojnë të drejtat e tyre kontraktore, për sa kohë ka mirëkuptim e vullnet të përbashkët.

18.1.5 Në lidhje me gjetjen mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, lidhur me të ardhurat neto të përfituara nga vetëpunësimi i bashkëshortit, deklaruar në shumën 2.000.000 lekë “sqarohet se kjo gjetje i përket një pasurie të krijuar gjate periudhës së kontrolluar me herët nga ILDKPKI dhe për të cilën nuk janë evidentuar gjetje që ngarkojnë me përgjegjësi subjektin sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë. ILDKPKI me raportin objekt kundërshtimi, ka arritur në konkluzionin se deklarimi i subjektit nuk është i saktë në përputhje me ligjin dhe nuk ka dokumentacion të plotë ligjor për të justifikuar burimin financiar të pasurive, ndërkohë që pranohet se paditësi nuk ka kryer fshehje të pasurisë, nuk ka kryer deklarim të rremë dhe nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

18.1.6 Në lidhje me gjetjen mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, lidhur me të ardhurat e deklaruara nga bashkëshorti në shumën 4.000.000 lekë, marrë si bonuse nga shoqëria "Gjergji H", mënyrën e përfitimit, si dhe raportin e punësimit të tij, me këtë shoqëri dhe gjetjen tjetër mungesë dokumentacioni justifikues, lidhur me burimin e shumave të kredituara në llogarinë e {...}{...} (bashkëshorti) në ProCredit Bank dhe Tirana Bank, shuma të transferuara periodikisht në llogarinë e shoqërisë "Gjergji H" shpk/shtetasit {...}{...}, gjatë periudhës 2004 - 2009, në total rreth 89.000.000 lekë”, sqarohet se kancelarja është subjekt deklarimi dhe është në dijeni të të gjithë dispozitave që përmban ky ligj që në momentin e marrjes së detyrës. Po kështu ajo ka

detyrimin ligjor të deklarojë çdo lloj pasuri, të paluajtshme dhe të luajtshme, likuiditete, të regjistruar ose jo në regjistrat publike, të cilat janë në emër të saj apo të personave të lidhur me të dhe që kanë detyrimin për deklarim, detyrim i cili rezulton të jetë përmbushur nga ana e saj. I gjithë ky konstatim në lidhje me keto gjetje i përkasin te ardhurave të krijuara përpara fillimit të detyrës si kancelare dhe përpara martesës ligjore, konstatim i cili është konsideruar i pabazuar sipas vendimit nr.2545, datë 07.06.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë., Kjo gjetje i përket një pasurie të krijuar gjate periudhës së kontrolluar me herët nga ILDKPKI dhe për të cilën nuk janë evidentuar gjetje që ngarkojnë me përgjegjësi subjektin sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Në nenin 451/a të K.Pr.Civile në të cilin është parashikuar se: “Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Vendimi që ka marrë formë të prerë ka fuqi vetëm për cka është vendosur midis po atyre palëve për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak. Një konflikt që është zgjidhur me vendim të formës së prerë nuk mund të gjykohet përsëri, përveç kur ligji parashikon ndryshe.”

Në lidhje me parimin e gjëse se gjykuar, Gjykata Kushtetuese shprehet se “Në jurisprudencën e saj Gjykata, në lidhje me parimin res judicata, ka vlerësuar se vendimi gjyqësor i formës së prerë, që përbën gjë të gjykuar, është shprehje dhe konkretizim i të drejtës mbi marrëdhënien juridike dhe ka qëllim t’i japë jo vetëm qartësi, por dhe siguri kësaj marrëdhënieje. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese e ligjore të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, pra në cenim të vetë sigurisë juridike. Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Ndërsa, në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që, në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Pra, kur vendimi ka marrë formë të prerë ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padi kundrejt të njëjtave palë (shih vendimin nr. 23, datë 8.6.2007 të Gjykatës Kushtetuese)..... Duke iu referuar jurisprudencës së saj, Gjykata ka çmuar se parimi i gjësë së gjykuar përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por dhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit, me kusht që të jenë kryer me qëllim të dhënies së vendimit gjyqësor dhe t’i përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj (shih vendimin nr. 24, datë 12.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese).

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur dhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila ka nënvizuar se “...në pikëpamjen e Gjykatës, parimi në bazë të të cilit një vendim përfundimtar i formës së prerë është gjë e gjykuar dhe zgjidh mosmarrëveshjen midis palëve me një efekt përfundimtar, është një element themelor i të drejtës për një gjykim të drejtë që garantohet nga neni 6 i Konventës në çështjet civile. Parimi i sigurisë juridike dikton që kur një mosmarrëveshje civile është shqyrtuar në themel nga gjykata, vendimi i saj nuk vihet më në diskutim...”.

Duke krahasuar gjetjet e trajtuara në Vendimin Nr.2545, datë 07.06.2017 të Gjykatës

Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i cili është i formës së prerë, periudhën për të cilën është ushtruar kontroll, e cila përfshin periudhën 2010-2015, me ato të trajtuara në përmbajtjen e Raportit Final të Kontrollit të përgatitur nga ILDKPKI, konstatohet se pjesa më e madhe e gjetjeve kanë gjetur trajtim në vendimin gjyqësor të formës së prerë, i cili për periudhën 2010-2015, nuk ka gjetur paligjshmëri në deklaratimet e bëra nga subjekti i kontrolluar.

Parimi i sigurisë juridike kërkon, midis të tjerave, sqaron që vendimet e formës së prerë të gjykatave të mos vihen në diskutim. Ndryshimi i praktikës së Gjykatës Kushtetuese për shtrirjen e sigurisë juridike edhe ndaj vendimeve gjyqësore erdhi si pasojë e vendimeve të GJEDNJ-së me palë shtetin shqiptar, ku ajo deklaroi se siguria juridike duhet të përfshijë edhe veprimtarinë e gjykatave. Në vazhdim të paprekshmërisë së vendimeve gjyqësore, Gjykata Kushtetuese ka deklaruar se në harmoni me parimin e sigurisë juridike ligji procedural civil ka sanksionuar edhe parimin e gjësë së gjykuar (res judicata), parim që pengon dhënien e çdo vendimi të ri mbi atë që është gjykuar. Në nenin 451/a të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se: 'Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët, për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Vendimi që ka marrë formë të prerë ka fuqi vetëm për çka është vendosur midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak. Një konflikt që është zgjidhur me vendim të formës së prerë nuk mund të gjykohet përsëri, përveç kur ligji parashikon ndryshe'. Në vendimin nr. 24/2008, Gjykata Kushtetuese ka theksuar se: 'Gjykata çmon se vendimi gjyqësor i formës së prerë që përbën gjë të gjykuar është shprehje e konkretizim i së drejtës mbi marrëdhënien juridike dhe ka qëllim t'i japë jo vetëm qartësi, por edhe siguri kësaj marrëdhënieje. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese e ligjore të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, pra në cenim të vetë sigurisë juridike. Prandaj, në vendimin nr. 23, datë 8.6.2007 ajo ka pranuar se '... vlerësimi dhe arsyetimi nga ana e gjykatave, lidhur me vendimin gjyqësor të paraqitur si provë nga ana e kërkuarit ka rëndësi dhe në kuadrin e respektimit të parimit të sigurisë juridike, si një nga aspektet themelore të shtetit të së drejtës. Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Ndërsa, në kontekstin e çështjes në shqyrtim, siguria juridike nënkupton që, në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim.

19. Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i mbledhur në datë 25.09.2023, duke konsideruar të plotë procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore dhe dokumentacionin e administruar në kuadër të saj, bazuar në pikën 25, Seksioni C, Kreu IV, të Vendimit 424/2020, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për kualifikimin dhe lejimin e kancelares në detyrë, znj. {...}, për të marrë pjesë në provimin e vlerësimit profesional ose për skualifikimin dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të saj të punës.

20. Në mbledhjen plenare të datës 06.12.2023, Këshilli mori në analizë të gjithë dokumentacionin e depozituar nga kancelarja në detyrë, duke e ballafaquar me të dhënat sipas të dy raporteve të ILDKPKI-së, si dhe duke marrë në konsideratë edhe shpjegimet e saj, arriti në

konkluzionin se të gjitha gjetjet e procedurës së verifikimit që lidhen me të dhënat dhe konstatimet për sa më poshtë:

- ✓ *Mos deklarim në deklaratën “Periodike Vjetore 2010”, të apartamentit me sipërfaqe 108.6 m2, me vlerë 93.736 euro dhe pagesave të kryera gjatë kësaj periudhe, në shumën 50.000 euro.*
- ✓ *Rezulton se pagesat nga bashkëshorti në shumën 7.500 euro, janë kryer në favor të llogarisë personale të administratorit z. {...} {...} në BKT dhe jo në emër të Shoqërisë “DAED” shpk.*
- ✓ *Referuar kontratës së shitjes nr. 33177798, datë 03.06.2019, rezulton se çmimi total i blerjes së apartamentit prej 93.736 euro është i likuiduar, sipas kontratës së porosisë të vitit 2011. Nuk është e qartë përfshirja e detyrimit të mbetur prej 22.236 euro, në çmimin e likuiduar, ndërkohë që në regjistrat hipotekorë apartamenti është regjistruar me çmimin përfundimtar të blerjes.*
- ✓ *Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, për pasqyrimin e detyrimit prej 22.236 euro, në debitorët/regjistrat e shoqërisë “DAED” shpk, sipas akt marrëveshjes së huas të datës 03.06.2019,*

u gjetën të bazuara dhe të trajtuara në vendimin e formës së prerë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë nr. 2545, datë 07.06.2017.

21. Nga verifikimi i kriterit të pasurisë për kancelaren në detyrë {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet për ekzistencën e shkaqeve të kualifikimit ose skualifikimit të saj. Konkretisht, rezulton se:

- a) kancelarja në detyrë dhe personi i lidhur kanë plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e deklaratës së pasurisë;
- b) kancelarja në detyrë dhe personi i lidhur kanë plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë;
- c) kancelarja në detyrë dhe personi i lidhur kanë burime financiare për të justifikuar pasuritë e tyre;
- d) deklarimi nga kancelarja në detyrë dhe personi i lidhur, i pasurisë, aseteve ose interesave private, të detyrueshme për t’u deklaruar, është i plotë, i vërtetë dhe i saktë referuar “*Deklaratës së pasurisë dhe interesave private të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë*”, datë 13.03.2021. Deklarimet e pasakta të konstatuara nga kontrolli i kësaj deklarate, nuk përbejnë shkak të mjaftueshëm për skualifikimin e kancelares në detyrë znj. {...}. Ky konkluzion arrihet duke iu referuar: (i) konstatimeve të organit kompetent për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, (ii) vlerësimit të dokumentacionit ligjor për të justifikuar burimin e pasurive të administruar gjatë hetimit administrativ në raport me qëndrimin e subjektit në proces verifikimi, (iii) mos evidentimit të qëllimit për mosdeklarim apo deklarim të paplotë të subjektit në raport me mangësitë e konstatuara, (iv) ekzistencës së vendimit të formës së prerë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë nr. 2545, datë 07.06.2017.

Ç. Për kriterin e figurës

22. Për kancelaren në detyrë, znj. {...}, u verifikua kriteri i figurës, përcaktuar në pikën 1, të nenit 83, të ligjit nr. 98/2016, sipas procedurës të parashikuar dhe në Seksionin C, Kreu VI të Vendimit 424/2020.

23. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të figurës, u kërkua raportim nga institucionet ligj zbatuese. Nga raportimet e shërbimeve shtetërore informative nuk u identifikua dhe verifikua ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme të kancelarit në detyrë me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e tij në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundërligjshme.

24. Për verifikimin e kriterit të figurës për kancelaren në detyrë, asaj iu kërkua depozitimi pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor i autorizimit për Këshillin që, në zbatim të pikës 82, të Seksionit C, të Kreut VI të Vendimit 424/2020, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, të të dhënave të saj në lidhje me figurën dhe integritetin.

24.1 Mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor⁸, Prokuroria e Përgjithshme ka kryer verifikimin përkatës në të gjitha prokuroritë që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, duke përcjellë në Këshill, me Shkresën nr.1699/255prot., datë 23.02.2021, përgjigjet zyrtare të 22 (njëzet e dy) prokurorive pranë gjykatave të rretheve gjyqësore të juridiksionit të përgjithshëm⁹. Referuar përmbajtjes së këtyre përgjigjeve, nga verifikimet e kryera, nuk rezultoi që kancelarja në detyrë të ketë marrë cilësinë e personit nën hetim në një procedim penal, ndaj saj të jetë regjistruar

⁸Shkresa nr.5833/7prot., datë 04.12.2020 e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

⁹Shkresa nr. 1762/1 Prot., datë 11.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet; shkresa nr. 1367/1 Prot., datë 14.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë; shkresa nr. 3850/1 Prot., datë 14.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat; shkresa nr. 420/1 Prot., datë 15.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës; shkresa nr. 1369/1 Prot., datë 16.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat; shkresa nr. 3768 Prot., datë 15.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë; shkresa nr. 365/1 Prot., datë 16.02.2021 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë; shkresa nr. 2955/1 Prot., datë 15.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë; shkresa nr. 8284/1 Prot., datë 08.03.2021 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin; shkresa nr. 1239/1 Prot., datë 16.03.2021 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec; shkresa nr. 15418/1 Prot., datë 28.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë; shkresa nr. 3768 Prot., datë 15.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë; shkresa nr. 11820/1 Prot., datë 05.01.2021 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë; shkresa nr. 8658/1Prot., datë 17.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë; shkresa nr. 1631/1 Prot., datë 15.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës; shkresa nr. 12300 Prot., datë 18.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan; shkresa nr. 9766/1 Prot., datë 17.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër; shkresa nr. 12931/1 Prot., datë 18.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë; shkresa nr. 9360/1 Prot., datë 16.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier; shkresa nr. 6251 Prot., datë 20.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë; shkresa nr. 2407 Prot., datë 23.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër; shkresa nr. 1025 Prot., datë 31.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë; shkresa nr. 2616/1 Prot., datë 15.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë.

kallëzim/referim/procedim penal, ndaj saj të jetë zbatuar ndonjë masë me karakter personal ose pasuror, ose të ketë të dhëna për procedime penale të mos filluara, të pushuara dhe të pezulluara.

24.2 Gjithashtu, dhe në përgjigjen e Prokurorisë së Posaçme kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit, me nr.3098/1, datë 21.04.2021¹⁰, nuk rezultoi që kancelarja në detyrë të ketë marrë cilësinë e personit nën hetim në një procedim penal, ndaj saj të jetë regjistruar kallëzim/referim/procedim penal, ndaj saj të jetë zbatuar ndonjë masë me karakter personal ose pasuror, ose të ketë të dhëna për procedime penale të mos filluara, të pushuara dhe të pezulluara.

20.3 Mbi kërkesën e Këshillit të Lartë Gjyqësor¹¹, Byroja Kombëtare e Hetimit, me shkresën nr.270/1 Prot., datë 28.06.2021, ka informuar se nuk disponon asnjë informacion në lidhje me kancelaren në detyrë.

25. Në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 138/2015, “*Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike*”, rezultoi se kancelarët në detyrë, ndër ta dhe znj.Hysi, kanë dorëzuar formularin e vete deklaramit pranë Ministrisë së Drejtësisë, si organi i tyre i emërtesës në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit dhe plotësimit të formularit. Mbi kërkesë të Këshillit, me shkresën me nr. 6906/1prot., datë 12.11.2020, Ministria e Drejtësisë ka njoftuar se struktura përgjegjëse pranë saj, ka përcjellë formularët, bashkë me dokumentacionin përkatës, Departamentit të Administratës Publike¹². Si rrjedhojë, me shkresën nr.5594/2prot. datë 19.11.2020, i është kërkuar Departamentit të Administratës Publike vendosja në dispozicion e formularëve të vetëdeklarimit, të dorëzuar nga kancelarët në detyrë, si dhe i të gjithë dokumentacionit të krijuar në lidhje me administrimin dhe verifikimin e tyre. Me shkresën nr.6084/1prot., datë 24.11.2020¹³, nga Departamenti i Administratës Publike është depozituar në Këshill formulari i vetëdeklarimit, sipas të cilit rezultoi se është dorëzuar nga znj.Hysi, në datë 27.04.2016. Po kështu, janë përcjellë dhe të dhënat e përfituara nga procedura e verifikimit sipas shkresave nr. 3290/2prot., datë 30.05.2016, nr. 3759 prot, datë 03.06.2016 dhe nr. 3826/1prot., datë 22.06.2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile si dhe shkresave nr. 4303/1prot., datë 13.07.2016 dhe nr. 4304/3prot., datë 27.06.2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

25.1 Pas vendosjes në dispozicion të formularit të vetëdeklarimit, në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 138/2015, “*Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike*”, nga ana e Strukturës së Posaçme për Regjistrimin, Administrimin dhe Përpunimin e Formularëve të Vetëdeklarimit, janë kryer verifikimet e thelluara të të dhënave të formularit të vetë deklarimit për gjendjen gjyqësore dhe gjendjen civile të kancelares në detyrë. Në përfundim të procedurës së verifikimit nga nëpunësi përgjegjës, pasi u kryen verifikimet e rastit, është arritur në përfundimin se kancelarja në detyrë, znj.{...}: “- ka

¹⁰Kthyer në bazë të shkresës kërkesë për informacion me nr.5679/19prot., datë 13.04.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

¹¹Shkresa nr.2805 Prot., datë 14.06.2021 e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

¹² Shih shkresën nr.6906/1prot., datë 12.11.2020 të Ministrisë së Drejtësisë, me objekt “Kthim përgjigje shkresës nr.5594prot., datë 30.10.2020”, protokolluar në Këshill me nr.5594/1prot., datë 16.11.2020.

¹³ Depozituar me nr.5594/3Prot., datë 26.11.2020.

dorëzuar formularin e vetëdeklarimit më datë 27.04.2016; ... - në formular nuk ka të deklaruar të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga ligji; - nuk ka deklaruar gjeneralitete të mëparshme, veç mbiemrit para martesë “Shehu”; - Sektori i Gjendjes Civile, sipas të dhënave në aktin e lindjes, përbërësi i gjendjes civile rubrika e emrit të nënës rezulton “Tanja”. Me lidhjen e martesës me datë 25.6.2002 përbërësi i gjendjes civile, rubrika e emrit të nënës rezulton të jetë pasqyruar gabim nga (“Tanja” në “Tonja”); - Sektori i Gjendjes Gjyqësore, personi rezulton (i padënuar) nga gjykatat penale shqiptare; - deri më sot nuk kemi patur indicie apo të dhëna kryesisht, për të kërkuar verifikim të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme”.

26. Nga verifikimi i kriterit të figurës për kancelaren në detyrë, znj. {...}, janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet për ekzistencën e shkaqeve të kualifikimit ose skualifikimit të saj. Konkretisht, rezulton se:

- a) kancelarja në detyrë ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e vetë deklarimit sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015;
- b) kancelarja në detyrë ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimin për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 83, Seksioni C, Kreu VI të vendimit 424/2020, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e tij;
- c) për kancelaren në detyrë nuk ka të dhëna për lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
- d) për kancelaren në detyrë nuk ka ndonjë të dhënë tjetër në lidhje me figurën dhe integritetin e tij, mbi të cilën të ngrihen dyshime për vazhdimin e marrëdhënies së saj të punës në shërbimin civil gjyqësor.

III. KONKLUZIONE

27. Referuar përcaktimeve të Vendimit 424/2020, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të pozicionit, pasurisë dhe figurës për kancelaren në detyrë, znj. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

28. Bazuar në sa është parashtruar më lart mbi rezultatet e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të pozicionit, pasurisë e figurës, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kancelarja në detyrë përmbush këto kritere dhe nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e saj. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për kualifikimin e kancelarit në detyrë dhe lejimin e saj për të marrë pjesë në provimin e vlerësimit profesional të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 83, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 61, pika 1, 86 shkronja “ë” dhe 97 pika 1, shkronja “a” të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 424, datë 12.10.2020, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore e ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Kualifikimin dhe lejimin për të marrë pjesë në provimin e vlerësimit profesional të kancelares në detyrë, znj. {...}.
2. Një kopje e vendimit të arsyetuar t’i njoftohet kancelares në detyrë, znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqjen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR